



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 18

Datë: 24. 05. 2017, ora: 17:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Nenad Rikallo, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

- Shqyrtimi i procesverbaleve Nr. 15 dhe 16 /2017

2. Aktivitetet e SKQZ-së

3. Aktivitetet e ZRPP-së

- Rekomandim për certifikimin e kandidatet të disa subjekteve politike të verifikuar nga ZRPP-ja, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës.

4. Mbikëqyrja e prodhimit të fletëvotimeve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës

5. Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KOZ-së

Shqyrtimi i procesverbaleve Nr. 15 dhe 16 /2017

Valdete Daka: Po fillojmë...Kemi dy apo tri pika të rendit të dites. A ka dikush ndonjë propozim?

Betim Gjoshi: Ne, e kemi para vetes si material të zyres... Është bazuar në ligjin e zgjedhjeve, udhëzimi për tërheqjen e shortit. Por dallon procedura, sepse na detyron ligji. Nuk e kemi bërë herën e kaluar, e kemi sjellë kësaj here një version. Është diskutuar në këshill të operacioneve, dhe le te futet si pikë e rendit të ditës.

Valdete Daka: Si udhëzim nga KOZ-i, apo...?

Betim Gjoshi: Si udhëzues për renditjen e subjekteve politike.

Valdete Daka: Pika pesë, rekomandim nga KOZ-i..., po...?

Miradije Mavriqi: Vetëm një edhe një sqarim: dje, janë certifikuar subjektet politike. Është certifikuar një koalicion, sepse, koalicionet paraprakisht e kanë pasur afatin. Mirpo, në ndërkohë janë tërhequr një pjesë e një koalicioni. A do të mbetet emri i certifikuar i subjektit politik, apo duhet sot të qertifikohet kjo si një parti e vetme? Është qertifikuar koalicioni, por ajo pjesa që është e koalicionit është tërhequr. Nuk mundet me hy ai që del prej koalicionit. Mbetet ai tjetri...

Betim Gjoshi: Kryetare, ne dje e kemi qertifikuar. Ne, edhe me deshtë edhe me u tërhequr një koalicion, prej ma të madhit emrin nuk mundemi me nderhy. Është qertifikuar komplet qysh ka qënë koalicion. Kandidat kanë qënë të koalicionit, nuk ka rëndesi a tërheqen a vijnë. Ne mundemi për mirëkuptim, në qoftë se nuk i prishet proceduralisht me zëvendësu për ndryshe ne asnjë obligim tjetër nuk kemi. Edhe pse ajo na prish afatet, në qoftë se ka mbetur keq për kandidat mundemi, për ndryshe përkohet apo diçka nuk po du me hy më tutje.

Valdete Daka: At`here kush është për këtë rend dite me shtesën e propozuar ? Vazhdojmë me pikën e parë proces verbalet 15-16. A ka dikush vërejtje...? Nëse jo: kush është për miratimin e këtyre proces verbaleve...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbaleve nr. 15 dhe 16 /2017

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Enis Halimi: Tani, jemi në fazën e aktivitete të zakonshme. Po vazhdohet me gjitha njesitë në kapacitet të plota, si me opercaion të votimit jashtë shtetit po ashtu kemi përfundu me trajnimin e KKZ-ve dje qendra e votimit është duke viju trajnimin e stafit menagjues që e ka të vetin dhe objektin. Përgjigjësisht, janë aktivitete të pritshme dhe shkojnë në mënyrë vijuese nuk ka diçka.

I nderuar kryeshef, na kan mbetur edhe 17 ditë faktikisht 16 ditë përgaditje e diellja nuk është ne dorën tonë a po shihni ndonjë sfid në diqka a keni ndonjë problem dmth që mendoni që jemi vonuar në afate apo jeni vonuar ju apo nuk ju ka ecur për së mbari, edhe a keni marrur ndonjë masë që në aspektin e logjistikës ti kemi gjitha kushtet p.sh. fletëvotime, a kemi kabina a kemi kimika d.m.th gjërat elementare rripat e sigurisë qa i lypë procedura jonë me i pasë, kjo është me rëndësi me i pasë si janë duke shkuar këto, se e di qe pjesën operacioneve na ke përshkru qe 2-3 mbledhje po në këtë aspekt e di që nuk kemi pas informacion logjistik. Edhe aspekti logjistik edhe i prokurimeve edhe i këtyre proceseve buxhetore, është duke shkuar me një dinamik relativisht të përcaktuar, të parapar nuk ka diqka që ja vlen të theksohet veq probleme të zakonshme që kemi pas dhe i kemi raportu këtu që kanë qenë me disa vonesa edhe ne kuptim të disa kërkesave që kanë pasur instucionet qëndrore të prokurorimit në kuptimin e publikimit elektronik e këtyre gjërave. Besoj i kemi adresu ato me shkresa i kemi procesu dhe tash jemi veq në fazën e nënshkrimit dhe kontratave dhe me prit me sjell materiale.

3. Aktivitetet e ZRPP-së

- Rekomandim për certifikimin e kandidatet të disa subjekteve politike të verifikuar nga ZRPP-ja, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës.

Miradije Mavriqi: Zyra, duke u bazuar në vendimin e juaj lidhur me verifikimin e kandidatëve të subjekteve politike që i përkasin etniteteve pakicë në Republikën e Kosovës ka bërë kërkes me shkrim Agjensisë së Entit për statistika dhe gjithashtu kur ka marrur përgjegje prej ati agjencionit, at'here ju ka drejtu agjencionit për regjistrin civil të cillët kan dëruar vetëm një numër të vogël të cillët janë verifikuar ata kandidat të listave të subjekteve politike për cillat ne kemi kërkuar sçarime atë list e keni edhe ju. Gjithashtu, zyrja ka përgaditur rekomandimin për çertifikimin e kandidatëve të komunitetit pakicë të Republikës së Kosovës të cillët kan aplikuar, edhe subjektet politike janë çertifikuar tani kanë mbetur kandidatët. Janë kontrolluar të gjith kandidatët do të thot a gjenden në regjistrin civil, janë kontrollu edhe a i përputhen ato të dhëna, po gjithashtu edhe kota gjinore. Zyra konkludon që të gjitha të dhënat janë komform ligjit edhe të gjitha listat e këtyre subjekteve politike janë të përfshira edhe kota gjinore ajo 30% që kërkohet me ligj. Ju i keni edhe listat e secillit subjekt politik ose kandidatit të tyre kryetare, tash nuk e di a duhet të fillojm ne me emër ti lexojmë të gjith kandidatët apo vetëm numrat e kandidatëve.

Ercan Spat: Fillimisht, unë nuk kam marrur asnjë përgjegje d.m.th është mos marrveshje rastësisht tek një koleg e pashë pa syza nuk i kam lexuar, e dyta: po më intereson gjithë korespondenca e cilla është bërë prej zyrës me instucionet e Republikës së Kosovës në lidhje me qështjen, edhe tjetra sipas materialit që unë i kam vetëm për qështjet parimire, besomni kolegët e mi shumica janë të informuar se dje isha për të votuar shkaku interesit të procesit për Republikën

e Kosovës të votoj tër listën pro me ditën e djeshme. Po pasi që u dha një propozim dhe i hyrëm një pune unë me këtë situat që kemi këtë moment po ndihem se dikush më ka tërheq 24 orë për hunda ashtu që unë do ta apstenoj prap për interes të procesit nuk do të votoj pro.

Betim Gjoshi: Nëse më lejohet...! E para ne e kemi është mirë me pa korespodencën, sepse e kemi një flet që nuk i përfshin gjitha rastet që ne i kemi ngritur si problem, është mirë me pa qfar ju ka dërguar a ju ka dërguar lista komplet. E dyta: une dje jo rastësisht e kam ngrit jo për shkat të ankesës së një subjekti politik, por kam parë edhe me syt e mi emra që në zgjedhjet e kaluara kan pas të regjistruar parti Shqipëtare, tjera zgjedhej kan ardhur kan regjistruar parti Rome, tani kan ardhur boshnjak, do thot njeriu nuk mundet në të njejtin instucin tri cikle zgjedhore që kan qenë brenda gjashtë viteve të ndrohen tri here. Nuk është ajo ndonjëfar lluksi që mundesh me ndërru, edhe këtë problematik e kam paraparë se ne po përballemi me një sfidë kur e dijmë që komunitetet i kemi të vogla. P.sh njëri prej komuniteteve Romë zakonisht maksimale ndonjëher që kan pasur kan qenë 300 e ca vota edhe kështu që neve na rrezikohemi që neser me u kriju kësi procedant me prish balance etnike në Kosovë në kuptimin e vendeve që kanë të garantuara. Unë në këtë aspekt jam ngritur dje, d.m.th unë si propozues më takon me tregu që nuk ka pasur ndonjë far qëllimi, ju lejohet njerëzve me pas lista multietnike në bazë të ligjit, por ju lejohet për vende jo të rezervuara jo të garantuara realisht.

Për vende të garantuara, tha z. Gjoshi, ju takon njerëzve të asaj kombësije të garojnë, për ndryshe ne mundemi me qertifiku listën complete siç e ka pru, vetëm garant nga pjesa e vendeve tjera që është 100 i vendeve, edhe pse në atë pjes pastaj është problem pjesa tjetër e komunitetit pra ne duhet me pa në të dy anët e kësaj, drejtoresha tha se jam në pajtim me ligjin, unë mendoj se ka pas në pajtim me nenin 29 sepse ashtu e ka shkruar sepse komplet me ligjin nuk janë sepse ligji nuk e ka vetëm një nen i ka edhe 111 për vendet e garantuara sepse këto kan garuar për ato vende dhe për ato vende duhet të jen të asaj etnis sepse nuk ka asnjë kuptim me garu personat e etnis tjetër për vendet e etnis tjetër. Unë nuk besoj se është në rregull as me garu serb për vendet e boshnjakëve as boshnjakët për vendet e serbëve, siç është as shqipëtarët për vendet e tjerëve sepse ne nuk duhet të shohim prej një prizme të ngusht, mua nuk më intereson sepse mua nuk më rrezikon. Ne si instucin Komisionit Qëndror Zgjedhor duhet ta ruajmë frymën e ligjit kushtetues me afru kushte të barabarta të gjithëve bazuar në frymën kushtetuese të ligjit, sepse nuk është çështje e thjeshtë kjo punë, nuk është bash e rastësishme që ligjëvënsi i ka lën siç i ka lën, ne e kemi për detyrë me implementu dhe ti krijojmë të gjitha kushtet, në kushte normale ne nuk është dashur ti kthejm në KQZ është dashur që zyrja tju tregoj këtë punë. Sepse një pjes të tyre i ka njohur personalisht, ka pas punë jashtëzakonisht shumë gjatë me ta është dashur tju tregoj d.m.th ju si zoti Erxhan po për dy subjekte politike ku kam dyshime edhe ku kemi argumente qe janë kundër d.m.th na kan pruar një list për sa kam mbërritur ta verifikoj pesë persona që i takojn një komuniteti Shqipëtar që kanë deklaruar vet kombësin në regjistrimin e fundit të popullsis të Kosovës të vitit 81 ose 80 mos të gabohem agjensionit i regjistrit civil që na ka fvardu gjithve si e-mail dhe na ka obligu d.m.th që këta katër perosna jan renditur të gjithë në një subjekt politik edhe gjithësesi jo abstenim po unë do të votoj kunër nëse nuk hiqen këta njerëz prej listave. Unë

nuk kamë tjetër mundësi tjetër se mua më obligon ligji, kushtetuta në bazë të cillit jamë i thirrur me vepru.

Valdete Daka: Aq më tepër që këto subjekte, nuk kanë prag...

Miradije Mavriqi: Më lejoni vetëm për një sçarim, unë kërkoj falje. Unë thash të dhënat e kandidatëve që janë të regjistruar në regjistër, të dhënat i kemi krahasuar dhe të dhënat janë komform legjislacionit nuk thash që për komunitete apsolutikisht po vetëm se përputhen numri i letërnjoftimit me regjistër civil kaq.

Valdete Daka: Vetëm kam një pyetje drejtoresh. A ka mundësi që këta deri neser të na dërgojn edhe për këtë pjesën tjetër sepse këtu është vetëm një pjes e listës d.m.th ajo është kontrolluar sa po e shoh une vetëm një subjekt edhe ajo është kualiconi SDA BSDK ndërkaq ka edhe subjekte tjera që kan të njejtin problem.

Miradije Mavriqi: Drejtori i agjensionit më tha që me pas më tepër kohë sepse koha shumë e shkurt sigurisht që do të hulumtonin edhe për tjera raste mirëpo për shkak afatit të ngjeshur kjo ka qenë...

Valdete Daka: At`here unë kisha propozu....!

Adnan Rrustemi: Po në lidhje me këtë janë të pa qarta gjërat e para për mua është ma e komplikuar se që po prezantohet personalisht mendoj nuk është, por prap po e them pikërisht që është me e komplikuar se qe po prezantohet nuk është që kam qendrim të qartë se cilla duhet të ishte çasja e KQZ-së për këtë situat. Unë vetëm dua ta sçaroj, ky rekomandimi që na u lexu prej zyrës është rekomandimi i njejt me të djeshmin a është i ndryshuar sepse nuk e kuptoj, a ka ndryshu ne emra rekomandimi që na lexuat nga rekomanimi i djeshmin apo jo, vetëm përgjegje po-jo ta dijme a ka ndryshu a jo, apo është i njejt...?

Valdete Daka: Dje vetëm subjektet politike, sot është kandidatët e tyre...Po a është lista e njejt e kandidatëve që ka qenë edhe dje?

Adnan Rrustemi: E dyta: në aspektin procedural tash mendova se na kan pruar rekomandim të ri me emra të kandidatëve në bazë të ketyre diskutimeve dhe shkresa të shkëmbyera mes këtyre dy instucioneve. Do të thot ideja ishte se a është list e re që rezulton nga shkresat e këmbyera nga këto dy instucione apo jo, është e qartë që ne duhet ti ruajm disa parime që i vendos ligji kur bëhet fjalë për përfaqësim por në anën tjetër po ashtu është e qartë për mua që ligji të paktën minimalisht mundemi të themi që ka vakume ligjore që e rregullon këtë qështje sepse deri në cillin nivel të verifikimit mundet të lëshohet KQZ-ja për kandidatët që janë pjes të një subjekti politik në këtë rast jo kur janë kandidat të pavarur, sepse kur janë kandidat të pavarur janë shumë më leht për mua me shqaru këtë punë. Personalish po e them qartë nuk mendoj që është në përgjegjësi të KQZ-së me e verifiku dhe me vlerësu etnicitetin e kandidatit, po është në bazë të ligjit me vlerësu ata as nuk po pres të mbind dikush ndryshe ose jo vetëm po e shprehi mendimin

tem ta kemi të qartë se është qështje për me shpre opinjonin. Ky është qëndrimi im nuk është që pe them për me nxit diskutim as për mem bind dikush për të kundërtën, secili e ka pikëpamjen e tij, unë vetëm po e shprehi pikëpamjen e tim në mbledhje nuk jam i sigurt që KQZ-ja ka kompetencë në këtë nivel me bo vlerësimin e etnicitetit të kandidatëve.

E tjetra, tha z. Rrustemi, është që nuk po du me u lëshu andej por ka diskutime gjëra për mua qështë e vërteta po flasim në mënyr teorike mendimin tim po e jap se sa objektiv është përkatësia etnike edhe sa subjektive është, a janë tiparet kështu fizike objektive të matëshme se qfarë e bën dikënd shqipëtar ose serb, a ka elemente të tjera subjektive që njerëzit munden me u ndi si të till munden me kalu andej këndeje ky është debat tjetër po unë vetëm po du me shpreh mendimin tem për me rrumbullaksu duke qen kështu unë nuk jam i sigurt, kam drojën qështë e vërteta personalisht kështu nese i heqim si të till si KQZ mbi këtë bazë qa më tepër me tabela që as nuk janë për tu shoqëruara me shkresa zyrtare qështë e vërteta të paktën si kemi, unë kam frikë që ne i cënojmë të drejtat kushtetuese të individave të caktuar. Po sikur zyre PP-ja ta kishte bërë vlerësimin paraprak ta kishte marr përgjigjesin se ne e kemi një rekomandim këtu. Unë personalisht jam që rruga më e drejt për mua juridike do të ishte me rekomandimin e zyrës, dhe palët që e konsiderojnë që ju cenohen të drejtat në bazë të ligjit me apelu vendimin e KQZ-së në GZA-p edhe të shqarohet kjo juridikisht nuk jam për me marr përsipër si antar i KQZ-së këtë risk, vetëm këtë dashta ta them përndryshe le të shqarohet që mos të rrezikojm që secilli individualisht të përfshihet me një debat dhe një rrezik të shkeljes së ligjit.

Binak Vishaj: Duke parë se dy prej kolegëve e deklaruan votën që apstenim rezevat e mia sa i përket dy subjekteve politike, apstenim kundër njejt është. Unë obligohem me deklaru se edhe unë apstenoj nuk do të votoj për rezervat i kam njejt si dje edhe sot, të njejtat emra i sho që jam i bindur dhe e di se janë të komunitetit shqipëtar e që janë duke garuar për mua unë e kam të qartë që këta e kan të pa mundur me kandidu për vendet e garantuara sepse ato janë të garantuar me kushtetut për komunitetet që janë në kategori kushtetuese, ndërsa për në rast se dojn të kandidojnë për partit në vende të tjera apsolutikisht ne nuk ja ndalojm mu bo pjesë e secillës parti politike me hy ne garë po për vendet e garantuara unë e kam të qartë që e kan të pa mundur me marr pjesë sepse une i kam 500 vet dal i marr 500 vota edhe bëhem deputet nesër i bashkohem një grupi parlamentar nga ky instucion burojn këto ne i bëjmë këto na jepin mundësi me garu ose nuk ua japim mundësin me garu d.m.th unë e jap votën time kundër përshkak se duhen 2/3 do të thot ta dini edhe antarët e tjerë sepse mundet me ardh deri te mos çertifikimi.

Betim Gjoshi: Nuk e di sa prej juve keni qenë anëtar kur na ka ardhur një tendenc të regjistrohet një parti edhe me na u kriju një komunitet i ri në Kosovë, situata përafërsisht është e njejt edhe ata kan pru 500 nënshkrime ose 600 sa ka kërku rregullativa në bazë partin Maqedone në Kosovë, une nuk kam asgje kundër Maqedonisë sa kam kundër Kinës nuk kam problem po ne të gjith jetojm në Kosovë dhe e dijmë për afërsisht edhe çfar jetojnë këtu edhe çfar nuk jetojnë dhe çfar ka pasur. Kosova ka një histori secilla kombesi në Kosovë e ka një histori të vetën d.m.th

nuk kan ardhur sot nga Hana unë e di p.sh të paktën që në Malishevë nuk ka turq siç e dij që në Komoran nuk ka boshnjakë d.m.th kjo është punë shumë e lehtë e verifikuar nuk ka, mbi të gjitha në ent të statistikave është një dëshmi që mundemi me hy ne ëeb-faqe me shiqu që asnjë turk nuk është i regjistruar në Malishevë d.m.th ne nuk mundemi me i mbyll syt as nuk mundemi ti lemi njerëzit për interes, grusht votave me bo kësi mashtrime mbi të gjitha nuk mundemi me lëjm një njeri tri here brenda instucionit tonë me garu për tri lloj vende , nuk mundemi me ndejt ne mundemi me pas ndonjë interes me ndonjë subjekt politik, unë nuk po dua të bëj debat këtë punë po ne i kemi dy zgjedhje d.m.th kontestimi për momentim kemi për dy subjekte politike që janë këta, ne dje kemi bër një të mirë që nuk i kemi nda subjektet sepse kemi deshtur tju japim edhe një mundësi që mos me i baltos ato në kuptimin e publikut po sot kemi ardhur në një situat që nuk kemi ndryshe. Une për tjerat subjekte votoj, për dy e shpreha votën tem kundër d.m.th as ata nuk janë mi privu se i kemi çertifiku si subjekt qoftë se zyrja mundet me na siguru një rekomandim deri në fund të mbledhjes me emra të përmirsuar të paktën me këta që na ka argumentu këtu mirë në qofse jo prap edhe deri nesër për të shtyhet çertifikimi e tyre me ju kërku ti plotësojn këto vende, nuk jam ti penalozoj se nuk kam asgje une le ti bijnë sa kandidat kan çertifiku 30 p.sh. nëse kan kërku 30 le ti plotësojnë at here përsëri po të komunitetit të tyre, neve nuk na paraqet problem ky është qëndrimi im është e vërte që ka vakum ligji...

Ne, tha z. Gjoshi, të gjith e dijmë që për vendet e garantuara të rezervuara asnjë akt ligjor nuk është nxerr ti ndryshojmë ato po problemi është ne e kemi nxjerr një udhëzim, nuk na është kujtu ndoshta një udhëzim me nxjerr rregull sot nuk vlen asgjë po të paktën e kemi një kushtetut që e përcakton këtë punë shumë sakt edhe kemi nje ligj të zgjedhjeve që për afërsisht e krijon njëfar fryme sa i përket vendeve të garuara edhe e treta që është shumë e rëndësishme ne i fusim mu përcaktu subjektet politike për çfarë vende po garojnë, tani nuk mundemi ti lemi sepse me këtë vetëm duhet ti vesim a po don po bojka PDK-ja me garu me vendet e një komuniteti tjetër sepse mo nuk po prishka punë sepse nuk paskemi se si ti verifikojmë jo nuk mundemi me ndejt, unë e kuptoj Adnanin, Adnani ka të drejtë sepse instucionet e tjera nuk po na paisin me dokumentacione tjera mjaftueshëm po mundemi ta shtyjmë mundemi ta bëjmë një pauz të mbledhjes. Unë gjithmonë nuk jam të votoj kundër sepse dje i kemi çertifiku disa subjekte mundet dikush me na marr që ne po i bëjm tendenc, nuk kemi tendenc ndaj askujt, ne kemi me privu sot nje diqka që mundet me shku duke na u rritur, nuk jamë me kriju një pretendenc për të ardhmen kjo është e gjitha ajo. Edhe e treta nuk jam të ballafaqohem me Gjykatën Kushtetuese me shkelje të drejtave Kushtetuese që i bie në këtë rast që neve na vie deri te fitorja e nje kandidati shumicës se vendeve të garantuar, që pastaj të gjithëve na vjen, ose neser mvarët krijimi edhe vendim marrja për shum qështje siç janë prej këti rasti, këto janë qëndrimet e mia.

Ne, vazhdoi z. Gjoshi, mundemi me vazhdu ti miratojmë të tjerat, me prit këto dyja një rekomandim të zyres le të bisedon zyrja me këto dy subjekte tju tregon gjendjen tju tregon sakt edhe me emra kush është kundër se mu nuk më prish punë se nuk po e bej fshehurazi këtë punë, unë po e bëj për të mirë të Kosovës jo që kam ndonjë gjë ndaj subjekteve përkatëse sepse nuk e njo asnjërin personalisht edhe e treta është që ne mundemi me vazhdu edhe me pikat e tjera mos

ta miratojmë asnjë në qoftë se kemi asi mendimi kemi pika tjera vazdhojmë mbledhjen sot na ka qëllu fati me u rëndu kështu me ndejt tër ditën në mbledhje.

Valdete Daka: Në fakt kushtetuta është shumë e kuartë i kemi vendet e garantuara i kemi edhe vendet për të cillat garojnë shumica e populltës ajo Shqipëtar d.m.th 100 vende janë për partit apo subjektet politike të cillat garojnë si Shqipëtar ndërsa 20 vende të garantuar janë 10 për komunitetin Serb 10 për komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë. Është shumë e kuartë, edhe subjektet politike ne e tham i detyrohemi mu deklaruar se për cillat vende garojnë sepse ato subjekte politike nuk kanë as prag edhe prandaj edhe i kanë specifikat e veta cillat ju garanton Kushtetuta në qoft se ne i fusim Shqipëtarët në listat e tyre at`here ku është poenta e vendeve të garantuara. Edhe përgjegjësi e jona është sepse edhe ne e bëjm edhe shpërndarjen e vendeve pastaj në Parlament. Propozimi konkret që ne këto subjekte politike të cillat nuk e kanë këtë problem t`ju çertifikojmë kandidatët që të mos te zgjasim këtë procedur, këto dy subjekte që janë me probleme ai subjekti që tha Erxhani edhe një koalicion, a nuk tha Erxhani për një subjekt a jo...!

Ercan Spat: Erxhani, as nuk përmend parti as nuk ka akuzu ndokënd as nuk ka subjektiv prej cillit është ankes, unë sinqerisht dje mbasdite u gëzova shumë, thash... njëherë e përgjithmonë parimet të vendosen në këtë institucion..., përndryshe, une isha për me votu listën dje por sod une nuk jamë për me votu se përse me ndjet na 24 orë kurrfarë ndryshimi në institucionet tona zgjedhore nuk jemi në gjendje me komunikuar thjeshtë nuk jam i bindur që ne kemi komunikuar...me goj, as me imell..., kurrfarë letëre nuk ka...dhe, tash jam kundër...

Valdete Daka: Jo, është komunikuar zyrtarisht përmes imellit me personin zyrtar i Entit të Statistikave për shkaqe të sigurisë së konfidencialitetit të shënimeve për personale nuk ka dashtë me na ofru këto shënime për askënd ndërkaq ARC-ja i ka dërguar për shkak të afatit të shkurtë dhe shpjegimin e ka dhanë për vetëm për një subjektë për të tjerat nuk i ka dërgu shënimeve që do të thotë zdo ti dërgojë qikjo është tjetër shpjegim nuk ka

Ilir Gashi: Kryetare, kështu unë mendoj që na ose ata që nuk kanë telashe që mujna për me kry sodë e para e dyta këtyre tjerëve ti ja japin një afat deri nesër se i kemi 2 mundësi ose të ju tregojmë që deri nesër për me deklaruar që garoni për një 100 vende si shumica shqipëtare me kandidatë qysh i keni prur ose jeni të obliguar që deri nesër me i largu personat në fjalë nga lista..., kjo ska logjikë sepse, njëra ishte krejt banale që thojke “jam dhandërr i njërit shqiptar”, edhe mundet që njëri mundet me formu një parti minoritet edhe mi marrë krejt në listë mej shti shqiptarë edhe me garu për vende të rezervuar.

Por, tha z. Gashi, kjo nuk është e logjikës, kështu që deri nesër është mir që me ja dhanë këtë mundësi ose të futet në listë në shumicën shqipëtare me listën 100 vendëve ose deri nesër nuk

do ti qertifikojmë kandidatët të cilët i përkasin komunitetit shumicë...

Adnan Rrustemi: Nuk kam diqka por vetëm proceduralishtë nëse ma e drejtë është se a me i qertifiku apo mos me i qertifiku edhe me ja lanë mundësin që njerzeve për me u anku, që me fitu në kohën që i kanë dhe që na rrjedhin për , ka afate 24 orësh 72 or ne PAZP, 24 orë dhe 72 orë në gjykatë, 24-72 or në gjykatë kushtetues, o i qertifikojmë komplet dhe pala tjetër që mendon që ju ka cënu drejtat ankohet deri të vërtetohet kjo punë, ose si qertifikon KQZ-ja këta kandidatë dhe palës ja jep mundësin mu anku për me i shfrytëzu mundësit edhe neve mos me na u cënu afatet. Sepse, është e pa kuptim se çfarë do shtyerje dhe kërkesa me i bo presjon shkresa ja i hjek nëse janë të bindur si KQZ, qysh unë sjom që duhet me i hjekë. Le ti hjekë KQZ-ja, s'ja cërtifikon këta sa i ka, thjeshtë me votë sja qertifikon edhe e njofton zyrtarishtë dhe i thot tu kan qertifiku 12 nga 20 apo sa i ka pasur edhe qata 8 të tjerë e bajnë ankesën për mbrenda 24 orëve ose ja qertifikon komplet, pjesa tjetër ose e kushtëzon ose e cenon...

Betim Gjoshi: Edhe unë jam për me vazhdu, dhe ti kryejmë këto...Zzyra, le të terhjeket dhe le ta pregaditë rekomandimin për këto dyja se qysh e mendon edhe vet, në qofse aj mendon se duhet me i qertifiku le ti qertifikon, na i kemi pëerpara një dokument të RC-së se edhe unë jam për me i përfundu sod se e rrezikojmë procesin zgjedhorë i votojmë me votë po ose kundër , dhe përfundon edhe muhabeti i tyre...

Adnan Rrustemi: Vetëm edhe diqka dashta me shtu këtu janë ngritur ose disa palë të treta kushtimit po thomë, na nuk i kemi verifiku as një subjekt tjetër për këtë përmbajte nuk jemi të sigurt që ne një parti, nëse një parti romë nuk ka sërëb ose, në një parti tjetër..Çka dina ne qysh i kanë listat tjera, po flasim për ata që garojnë për vende tjera që janë të rezervume se, përshembull VETVENDOSJA, e ka një boshnjakë në listë, qartazi...

Betim Gjoshi: Adnani, e ka me drejtë..., unë, nuk kam dashtë për me blloku.

Binak Vishaj: Kryetare, dje kemi pasë rezerva me një shqyrtim të pjeshëm kemi gjetë 4 emra që janë shqiptarë me e rishqyrtu te gjithën të garantoj se ka me dal përmbi 40 që janë shqiptarë apo kupton edhe është shumë e vërtet, i kemi hy në hak atyre të tjerëve që si kemi kqyr këtë temë edhe tashmi atyre ju kemi hy tash këtyre le ti përmbahemi atyre që i kemi mundësi këta njëjt kanë me qenë me ty sikurse edhe sod që kanë qenë me arrogancë, e që na nuk i hjekim...

Valdete Daka: Atëher, po vazhdojmë na me qito subjekte që i kemi! A ti lexoj të gjitha, dhe ti certifikojmë kandidatët.

Pra, kush për që kandidatët e subjektit “GI-EUROMIN ALTERNATIVA” të certifikohen...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti, me dy vota abstenimi.

Valdete Daka: “GI-ZA POSTIRITET KOSOVA”. Kjo, është inicjativë serbe. Kush, është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti, me një votë abstenimi.

“GRAGJANSKA INICJATIVA GORE”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti, me një votë abstenimi.

“GRAGJANSKA INICJATIVA SERBSKA LISTA”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“JEDINSKE GORANSKA PARTIA”: Kush është për...?,

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“INICJATICA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“KUALICIA VAKAT”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“KOSOVA DEMOKRATIK TYRK PARTISI”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“KOSOVAKI NEVI PARTIJA”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“NAPREDNA SNAGA KOSOVA”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKALINJËVE TË KOSOVËS”: Kush është për.../

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“PARTIA KOSOVSKA SERBSKI” dhe “AKTIVNA GRAGJANSKA INICJATIVA”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti me një votë kundër, dhe një abstenim.

“POKRET ZA GORA”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“POGRESINSKA DEMOKRANSKA SNAGA”: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan certifikimin e kandidatëve të këtij subjekti.

“SAMO SNALLSKA LIBERALSTRANKA”: Kush është për...?

“NOVA DEMOKRANTSKA SNAGA”: Kush është për...?

Valdete Daka: Kualicioni, na mbetet edhe një here me komuniku me to, po presim edhe pak...

Betim Gjoshi: A po e miratojmë udhëzimin...?

Adnan Rrustemi: Po, në këshillin e operacioneve zgjedhore u prezantue si kërkes nga zyra për regjistrimin per regjistrimin dhe qertifikim e partive politike plotësimi ose në nje far mënyre hartimi i një llojë udhërrëfyesi se si do të zhvillohet ceromenia e heshtjes së shortit të tërheqjës se numrit nga subjektet politike për renditjen e fletë votimeve u dhanë disa ide dhe u plotësu... Natyrishtë dhe keni këtë dokumentë që përfshin procedurën se si do të tërhiqet shorti për të siguri një proces te drejt dhe transparentë po i lexoj 3 pika esenciale emrat e sbujekteve politike të qertifikuar për të marr pjesë zgjedhjet futën në topat e mbyllur apo në vazot e veqanta numrat rëndor që do të filloj nga numri 11 deri në numrin 37 të mbyllur po ashtut në topa që do të vendosen me një vazo tjetër. Zyrtarët e KQZ-së, do të tërheqin topat me emrat e subjekteve politike të qertifikuara nga vazoja e pare, dhe do të thërrasim emrat e zyrtarëve të përfaqësuesëve të subjketëve politike. Më pas, i njëjti përfaqësus i autorizuar, do të tërheq topin me numrin rëndor i cili, ndodhet praktikisht në vazon tjetër dhe që është numri i cili do të renditet në fletë votim. Konfirmojmë që është një proces i drejtë: emrin e subjektit politikë nga vazoja e pare, e tërheqë zyrtari i KQZ-s, ndërsa numrin e tërheq përfaqsesi i partisë politike...

Në këtë pikë, diskutuan pastaj: Bajram Ljatifi, Betim Gjoshi, Binak Vishaj, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Valdete Daka.

Aëtarët e KQZ-së, miratuan procedurat për tërheqjen e shortit lidhur me renditejen e subjekteve politike në fletëvotim.

(Pauzë e mbledhjes)

Per KQZ

Valdete Daka, kryetare

=====